



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” ADMINISTRATORI

Drejtoria e Shërbimeve dhe Prokurimeve në Rektoratit e Universitetit të Elbasanit “Aleksander Xhuvani”, shpall konkurs për pozicionin e punës personeli administrativ me kohë të plotë, specialist shërbimi.

Specialisti i shërbimeve: Zbaton me përpikmëri dhe me nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara nga eprorët e tij në lidhje me mirëmbajtjen dhe asistencën teknike për pajisjet elektronike dhe kompjuterike në institucion (konfigurime/instalime hardëare & Softëare/ instalime dhe konfigurime rrjeti. Jep përgjigje teknike për probleme specifike; përgatit propozime lidhur me trajtimin e çështjeve të ndryshme me karakter teknik dhe profesional; ndjek dhe raporton korrespondencën që i është dhënë për trajtim duke respektuar rigorozisht afatet e përcaktuara duke raportuar tek përgjegjësi i sektorit dhe drejtori i drejtorisë; mban përgjegjësi për cilësinë dhe saktësinë profesionale; punon për rritjen e aftësive vetjake tekniko-profesionale dhe merr pjesë në veprimtaritë trajnuese për këtë qëllim, në funksion të plotësimit sa më të mirë të detyrave të ngarkuara, të njohë legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë në atë që lidhet me punën sipas specifikës të fushës që mbulon.

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta:

Kriteret e përgjithshme:

- të zotërojë diplomë të ciklit (nivelit) të dytë të studimeve, ose ekuivalente me të në shkenca informatike. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njohura dhe njësuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- Të këtë përvojë pune.
- Të këtë njohuri të paktën e një gjuhe të huaj të vërtetuar me dokumentacion.
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta:

- të këtë mbi 2 (dy) vite përvojë pune në fushën e kërkuar
- Të këtë mbi 5(pesë) vite përvojë pune në mirëmbajtjen dhe asistencën teknike të pajisjeve elektronike.
- Të këtë aftësi të mira komunikuese e të punës në grup.
- të këtë kryer kurse apo kualifikime në fushën e informatikës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” ADMINISTRATORI

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Protokoll të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**12.09.2022 – 21.09.2022**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër motivimi për pozicionin e punës specialist shërbimi në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Prokurimeve në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (**12.09.2022 – 21.09.2022**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *specialist shërbimi*
Elbasan

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Rektoratit. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë (26.09.2022 – 07.10.2022). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen/njoftimi i fituesit.